



02/Nr. 9932/2018

Data: 04.12.2018

## PROCESVERBAL I KKSb-së

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë - XI- për vitin 2018 mbajtur me datë: 30.11.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Nuhi Dema** (përfaqësues i stacionit policor), **Menduh Vlasi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Ali Vishi** (përfaqësues i FSK-së), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Amir Bushi** (Zyrtar për barazi gjinore) **Hyrijete Isufi** (Komiteti për komunitet), **Isa Shkreta** (Përfaqësues i E.V.S.B).

Takimin e kryesoj Nënkrjetari i Komunës z. **Mallzum Qajani**.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Të ndryshme.

**Mallzum Qajani** pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Mallzum Qajani** a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse jo e hedh në votim dhe miratimi ishte njëzëri.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

**Mallzum Qajani** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nuhi Dema** sa i përket muajit Nëntor e kemi pasur muaj të qetë, në krahasim me muajin Nëntor të viti të kaluar kemi një rast më shumë, këtë muaj kemi pasur 6 raste të vjedhjeve, 1 rast të dhunës në familje, 1 lëndim të lehtë trupor dhe mashtrim.

**Mallzum Qajani** vjedhjet a janë nëpër shtëpi apo lokale.

**Nuhi Dema** kryesisht janë makineritë e Bektelenkës që janë duke punuar nëpër rrugët e Hanit të Elezit dhe që janë pa mbikëqyrje. Sa i përket gjendjes së përgjithshme nuk kemi pasur ndonjë rast të veçantë. Kemi pasur vështirësi në staf të policëve, nga data 15 Nëntor jemi në shërbim 12 orë ku kemi qenë më të ngarkuar dhe ende vazhdon kështu.

Ali Vishi nëpër shumë takime po raportohet se ka vjedhje në Bektelenkë, a ka vetëm vjedhje të derivateve apo edhe gjësendeve tjera, sepse e njëjta situatë është edhe në Kaçanik.

**Nuhi Dema** ka raste edhe të vjedhjeve të pajisjeve të punës, kur ne kemi dal në vend të ngjarjes janë kompanitë që ata i kompensojnë që mos me bërë dëm shpërblim.

**Menduh Vlasi** nga drejtori i SHML "Dardania" kërkohet që gjatë ditëve të premtë me pasur kontroll më shumë te shkolla, te kafiteria përball shkollës.

**Nuhi Dema** do të jemi në kontroll.

**Amir Bushi** te rastet e dhunës në familje, kisha një kërkesë nëse është e mundur sepse ne kemi pasur edhe dy viktima të dhunës në familje, që zakonisht martesat që po janë pa fëmijë është mirë që edhe ne me qenë në rast drejt për së drejti në stacion , sepse rastet kanë qenë tek ju, ju i keni drejtua për Ferizaj dhe viktimat e këtij rasti janë të vendit ton dhe ata mbesin pa përkujdesje të askujt. Ne me rregullore e kërkojmë që ka ose nuk ka fëmijë me u përkujdes që me rehabilitua atë familje.

**Nuhi Dema** sa i përket këtyre rasteve zakonisht na e përdorim ligjin e kodit penal të Republikës së Kosovës dhe kompetencat vendore nuk mundemi me i tejkalua dhe momentin ku ndodh vepra aty llogaritet vendi i ngjarjes dhe aty hapet rasti.

**Amir Bushi** është mirë që raportet të njoftohen menjëherë për arsye se viktimat pas një kohe vijnë me plagë tek ne dhe pas një kohe humbin plagët.

**Refet Kalisi** është duke u dëgjuar që droga është duke u përdor në komunën ton, është mirë që me pasur një përkujdesje më të madhe lidhur me këtë dukuri.

**Nuhi Dema** kemi njësit tona që merren me këtë punë dhe jemi në vëzhgim të tyre.

**Mallzum Qajani** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

## 2. Të ndryshme.

**Mallzum Qajani** lidhur me këtë pik hapi diskutimin.

**Nuhi Dema** tash është koha e vjeshtës dhe dimrit, nëse është mundësia që me bisedua me Ministrinë e Infrastrukturës për me bërë shënimin e vijave edhe në qytet po ashtu edhe në magjistrale.

**Isa Shkreta** rruga për në fshatin Seçishtë të vendosen shenja për ndalim parkim sepse shumë vetura parkohen gjatë rrugës.

Mbledhja përfundoi në ora 14:20 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi  
Irfan Suma

